

VENDIM
Nr. 318, datë 12.12.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2022, PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”; miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/4 prot., datë 7.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 8680 prot., datë 2.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2030 prot., datë 5.12.2022, shoqëria FSHU sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2022, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Nga aplikimi i shoqërisë rezulton se çmimi i propozuar për muajin nëntor 2022 për këtë kategori klientësh është 31.30 lekë/kwh, ku përpos elementeve të çmimit të njohur nga “Metodologjia e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, shoqëria ka përfshirë sërish kostot e disbalancave.

- Rezulton se në kërkesën e FSHU sh.a., reflektimi i kostove të disbalancave në çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja, në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa, që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori.

- Sikurse përcaktohet në Metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, kostot e disbalancave nuk njihen si komponent i përlllogaritjes së çmimit të FMF-së.

- Mbështetur në nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 74, datë 13.4.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga shoqëria FSHU sh.a., për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, janë njohur në vlerën 1.06 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2022, përlllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2022		
	Njësia	Çmimi
CB _{Et}	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh
TR _r	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh
TSH _t	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh
Çmimi i energjisë = CB _{Et} +Pr* CB _{Et} + TR _r +TSH _t +CA		Leke/kWh

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton, se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 31.21 lekë/kwh për muajin nëntor 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin nëntor 2022, prej 31.21 lekësh/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petril Ahmeti